

# Shërbimi i Fiskalizimit

(versioni v03)

## Versionet

Versioni i publikuar	Përshkrimi i ndryshimit
v01	Versioni fillestar
v02	<p>Shkurtohen emrat e fushave</p> <p>Shtohen kodet shtesë të gabimeve</p> <p>Shtohen kapitujt e gjenerimit të kodit NIVFSH (WTNIC)</p> <p>Shtohen URL-të të testit dhe prodhimit</p> <p>Në kapitullin hyrës vendoset terminologjia qëpërdoret në Ligj</p>
V03	<p>Ndryshohen URL-të të pikës fundore</p> <p>Modifikimet e gjenerimit i kodit QR , terminologjia ndryshohet</p> <p>Ndryshimet e kapitullit të regjistrimit të faturës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontrolli i datës dhe orës së dërgimit zhvendoset nga kontrollet e detyrueshme në ato fakultative</li> </ul> <p>Ndryshohet mesazhi i kërkesës për regjistrimin e të dhënave të së faturës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Elementi i lëshuesit riemërohet si shitës (në ndryshimet më poshtë elementi i riemërtuar do të referohet me emrin e ri)</li> <li>Atributi NUIS/NIPT-i i Shitësit zëvendësohet me atributet “IDNum” dhe “IDType”</li> <li>Adresa e shitësit, atributet e qytetit dhe të vendit ndryshohet në fakultative</li> <li>Atributi NUIS/ NIPT-i i Blerësit zëvendësohet me atributet “IDNum” dhe “IDType”</li> <li>Atributi i Arkës (Pajisjes Elektronike të Faturimit) “CashRegister” riemërohet si “TCRCode”</li> <li>Atributi TCRCode ndryshohet në fakultative</li> <li>Shtohet elementi i listës së tarifave “Fees”</li> <li>Shtohet atributi i afatit të pagesës “PayDeadline”</li> <li>Atributi Mënyrë Pagesë “PaymentMethod” zëvendësohet me elementin Listë e Mënyrave të Pagesës “PayMethods”</li> <li>Atributi Njësi Biznesi “BusinUnit” riemërohet Kodi i Njësisë së Biznesit “BusinUnitCode”</li> <li>Atributi SoftNum riemërohet SoftCode</li> <li>Shtohet elementi Valutë “Currency” (Monedhë), shtohen atributet Kodi i Valutës “Currency Code” (Monedhës) dhe Kursi i Këmbimit “ExRate”</li> <li>Shtohet elementi Data ose Periudha e Furnizimit “SupplyDateOrPeriod”, shtohen atributet Fillimi “Start” dhe “End” Përfundimi i Datës ose Periudhës së Furnizimit</li> <li>Elementi “SameTaxItems” riemërtohet “SameTaxes”</li> <li>Elementi “SameTaxesItems” riemërtohet “SameTax”</li> <li>Elementi “ConsTaxItems” riemërtohet “ConsTaxes”</li> <li>Elementi “ConsTaxesItems” riemërohet “ConsTax”</li> <li>Elementi “SameTaxes” ndryshohet në fakultative</li> <li>Tipi “TypeOfInv” e Faturës së Thjeshtë shtohet</li> </ul>

Versioni i publikuar	Përshkrimi i ndryshimit
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numërimi “TypeOfInv” ndryshohet</li> <li>• Numërimi “TypeOfSelfIss” ndryshohet</li> <li>• Atributi “SelfIssuing” hiqet</li> <li>• Atributi “SumCompCard” shtohet</li> <li>• Atributi “GoodsExport” riemërtohet “GoodsExAmt”</li> <li>• “RR” ndryshohet në i detyrueshëm</li> <li>• Atributi “InvNum” hiqet</li> <li>• Atributi “InvOrdNum” riemërtohet “InvNum”</li> <li>• Atributi “BadDept” riemërtohet “IsBadDept”</li> <li>• Atributi “IsBadDept” ndryshohet në i detyrueshëm</li> <li>• Atributi “ReverseCharge” riemërtohet “IsReverseCharge”</li> <li>• Atributi “IssuerInVAT” riemërtohet “IsIssuerInVAT”</li> <li>• Njesitë “VR”, “VA”, “R”, “RR” ndryshohet në fakultative</li> <li>• Atributi i njesisë “EX” shtohet</li> <li>• Riemërohet atributi UP në UPB</li> <li>• Shtohet atributi UPA</li> <li>• Karakteristikat e blerësit ndryshohen në fakultative</li> <li>• IsSubociationDelivery kalon te elementi Header</li> <li>• Shtohet kontrolli nëse lëshues është aktiv dhe detyrues i TVSH</li> <li>• Atributi “SameTax” dhe “ExemptFromVAT” shtohet</li> </ul> <p>Kapitulli Regjistro një TCR ndryshohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Riemërtim i Regjistro TCR</li> <li>• Përshkrime të shtuara shitesë</li> <li>• Kontrole të përgjithshme të detyrueshme shtohen</li> <li>• Kontroll i detyrueshëm për kohën e dërgimit shtohet</li> </ul> <p>Ndryshohet mesazhi i kërkesës Register TCR:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Atributi “RegDateTime” hiqet</li> <li>• Atributi “BusinUnit” riemërtohet “BusinUnitCode”</li> <li>• Atributi “TCROrdNum” riemërtohet “TCRIntID”</li> <li>• Lloji i të dhënës “TCRIntID” ndryshohet në tekst (string)</li> <li>• Atributi “SoftNum” riemërtohet “SoftCode”</li> <li>• Atributi “ManufacNum” riemërohet “MaintainerCode”</li> <li>• Shtohen atributet ValidFrom dhe ValidTo</li> <li>• Atributet “SoftCode” dhe “MaintainerCode” u ndryshuan në fakultative</li> </ul> <p>Ndryshohet mesazhi i përgjigjes RegisterTCR:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Elementi “TCRNumber” riemërtohet “TCRCode”</li> <li>• Modeli i llojit të të dhënës “TCRCode” ndryshohet</li> </ul> <p>Kapitulli Regjistro TCR gjendjen e parave në dorë ndryshohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistro gjendjen e parave në dorë riemërtohet</li> <li>• Përshkrimi shitesë shtohet</li> <li>• Kontrole të përgjithshme të detyrueshme shtohen</li> <li>• Kontroll i detyrueshëm të kohës së dërgimit shtohet</li> </ul> <p>Ndryshohet mesazhin e kërkesës Register TCR për gjendjen e parave cash:</p>

Versioni i publikuar	Përshkrimi i ndryshimit
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Atributi “TCRNumber” riemërtohet “TCRCode”</li> <li>Modeli i llojit të të dhënave “TCRCode” ndryshohet</li> <li>Numërimin operacional ndryshohet në INITIAL, IN, OUT</li> <li>“IsSubsequentDelivery” shkon tek elementi Header</li> </ul> <p>Mesazhi i përgjigjes Regjistro gjendjen e parave cash TCR ndryshohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Elementi “FCBC” shtohet</li> </ul> <p>Kapitulli PKI riemërtohet certifikata elektronike dhe shtohen përshkrime.</p> <p>Mesazhi i gabimit ndryshohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Elementi “RequestUUID” ndryshohet në fakultative</li> <li>Elementi “ResponseUUID” shtohet</li> </ul> <p>Kontrolle të shtuara për metodën e çregjistrimit e pajisjes elektronike të faturimit (TCR):</p> <p>Kontrolle:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontrollet e zakonshme të detyrueshme i shtohen një kapitullit të veçantë.</li> <li>Kontrolle fakultative riemërtohen kontrolle shtesë</li> <li>Lista e kontrolleve shtesë hiqet</li> </ul> <p>Kapitulli i përmbajtjes së faturës shoqëruese hiqet.</p> <p>Shembuj XML të përditësuar.</p> <p>Shtohen shembuj codesh .NET C# për gjenerimin e nenshkrimit.</p> <p>Atributet “Id” dhe “Version” shtohen.</p> <p>Modifikohen Modelet e skemës për të marrë në konsideratë vleshmërinë (validimin) urgjente</p>

## Dokumenta të lidhur

Emri i Dokumentit	Përshkrimi
Shërbimi i Fiskalizimit – Specifikime Funksionale	Të gjitha proceset përshkruhen

## PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE.....</b>	<b>7</b>
1.1 SHKURTIMET E PËRDORURA.....	7
1.2 TERMINOLOGJIA .....	8
<b>2. MJEDISET .....</b>	<b>10</b>
2.1 PUNA PËRGATITORE PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMIT TË FISKALIZIMIT .....	10
2.2 TOPOLOGJIA.....	11
2.2.1 Pika e aksesit të Platformës Qëndrore të Faturave (CIS) .....	11
2.2.2 Lidhja e internetit.....	11
2.2.3 Sistemi i informacioni të klientit .....	11
2.3 KUSHTET PËR LIDHJEN ME PLATFORMËN QËNDRORE TË FATURAVE (CIS) .....	12
2.3.1 Parakushtet dhe rekomandimet e rrjetit .....	12
2.3.2 Parakushtet e sigurisë.....	12
2.3.3 Parakushtet e zbatimit.....	12
<b>3. NDËRFAQJA .....</b>	<b>13</b>
3.1 VERSIONIMI I NDËRFAQES .....	13
3.2 KODIMI I MESAZHIT TË TË DHËNAVE.....	14
3.3 STRUKTURA E MESAZHIT TË TË DHËNAVE .....	14
3.4 KONTROLLE .....	14
3.5 REGJISTRIMI I TCR-SË (ARKËS) SË RE .....	15
3.5.1 Mesazhi i kërkesës për regjistrimin e arkës së tatimpaguesit.....	16
3.5.2 Mesazhi i përgjigjes me të dhëna për regjistrimin e TCR .....	19
3.5.3 Kontrollat e detyrueshme .....	20
3.5.4 Mesazhi i gabimit.....	21
3.5.5 Shembull XML .....	21
3.6 REGJISTRIMI I GJENDJES FILLESTARE TË PARAVE CASH NË TCR.....	22
3.6.1 Mesazhi i kërkesës për regjistrimin e gjendjes fillestare të arkës .....	23
3.6.2 Mesazhi i përgjigjes për regjistrimin e gjendjes fillestare të parave cash në TCR.....	26
3.6.3 KONTROLLE të DETYRUESHME .....	28
3.6.4 Mesazh gabimi.....	28
3.6.5 Shembull XML .....	28
3.7 REGJISTRIMI I FATURËS.....	29
3.7.1 Të dhënat e mesazhit të kërkesës për regjistrimin e faturës .....	33
3.7.2 Të dhënat e mesazhit të përgjigjes për regjistrimin e faturës .....	55
3.7.3 Kontrollat e detyrueshme .....	57
3.7.4 Mesazhi i Gabimit .....	58
3.7.5 Shembull XML .....	58
3.7.6 Eksportimi i të dhënave dhe ngarkimi .....	59
3.7.7 Gjenerimi i Kodit QR.....	60

3.8 FATURA SHOQËRUESE .....	62
3.9 MESAZHET E GABIMIT .....	62
3.9.1 <i>FORMATI XML</i> .....	62
3.9.2 <i>Kodet e gabimit</i> .....	64
3.9.3 <i>Shembull XML</i> .....	66
<b>4. SIGURIA.....</b>	<b>67</b>
4.1 ÇERTIFIKATAT ELEKTRONIKE .....	67
4.2 SIGURIA E TRANSPORTIT.....	67
4.3 SIGURIA E MESAZHIT .....	67
4.3.1 <i>Nënshkrimi i mesazhit të të dhënave të kërkesës dhe përgjigjes</i> .....	68
4.3.2 <i>Elementi i të dhënave të IIC</i> .....	68
<b>5. ANEKS - SHEMBUJ KODESH .....</b>	<b>72</b>
5.1 KODI I GJENERIMIT IIC .....	72
5.1.1 <i>Shembull Java</i> .....	72
5.1.2 <i>Shembull C#</i> .....	73
5.2 KODI I GJENERIMIT TË NËNSHKRIMIT .....	73
5.2.1 <i>Shembull Java</i> .....	73
5.2.2 <i>Shembull C#</i> .....	75
<b>6. ANEKS - WSDL VERSIONI 2 .....</b>	<b>76</b>
<b>7. ANEKS - XSD VERSIONI 2 .....</b>	<b>78</b>

## 1. Hyrje

Ky dokument jep një përshkrim të ndërfaqes së të dhënave për faturën dhe njohjes së mesazheve të të dhënave që përmbajnë informacion mbi shitjet të cilat tatimpaguesit janë të detyruar t'i dërgojnë për çdo shitje të bërë dhe që i nënshtrohen regjistrimit të shitjeve, d.m.th faturat e lëshuara.

Shembuj që përmbajnë përcaktimet e skemave XML dhe Web service (WSDL), të cilat përshkruajnë strukturën e mesazheve të regjistruara të faturave dhe Web service të përdorur për t'i marrë ato, janë dhënë si Shtojca 6 dhe 7 të këtij dokumenti.

Ky dokument siguron specifikime për versionin 2 të shërbimit të fiskalizimit.

Versioni i mëparshëm i shërbimit të fiskalizimit do të jetë në dispozicion për 4 javë pasi të dalë versioni i ri. Data kur lëshohet versioni i ri mund të gjendet në faqen e internetit të DPT

<https://www.tatime.gov.al/eng/c/320/327/fiscalization-service-technical-specifications>.

### 1.1 SHKURTIMET E PËRDORURA

Shkurtimi	Përshkrim	Terminologjia e përdorur në Projekt-Ligj (nëse është ndryshe)
CA	Autoriteti i Certifikimit	-
CIS	Sistemi qendror i faturave	-
CPCM	CPCM është portal qendror për kontrollin dhe menaxhimin e tatimpaguesve në nënsistemin e transaksioneve me para në dorë	-
CRL	Lista e Certifikikatave të Revokuara	-
FIC	Kodi i identifikimit fiskal ( gjeneruar nga serveri pas verifikimit të suksesshëm të faturës)	NIVF – Numri identifikues i veçantë i faturës
FNIC	Kodi i Identifikimit të Faturës Shoqëruese Fiskale (i gjeneruar në anën e serverit pas verifikimit të suksesshëm të faturës shoqëruese)	NIVFSH - Numri identifikues i veçantë i faturës Shoqëruese
GUID	Identifikuesi Unik Global (Global Unique Identifier)	-
IIC	Kodi i lëshuesit të faturës	NSLF – Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës
NIC	Kodi i Identifikimit të Faturës Shoqëruese	NSLFSH - Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës Shoqëruese
NUIS	Numri i identifikimit unik kombëtar	NUIS/NIPT
OCSP	Protokolli i Statusit të Certifikatës On-Line	-
SOAP	Protokolli i shkëmbimeve të mesazheve për XML siç specifikohet në: <a href="https://www.w3.org/TR/soap/">https://www.w3.org/TR/soap/</a>	-
TCR	Arka e tatimpaguesit. Njësoj si pajisja e arkës ose pajisja elektronike.	Pajisja elektronike e faturimit
TCRCode	Numri i arkës së tatimpaguesit	Numri i pajisjes elektronike të faturimit
UC	Rastet e përdorimit	-
UUID	Identifikues unik universal (Universally Unique Identifier)	-

Shkurtimi	Përshkrim	Terminologjia e përdorur në Projekt-Ligj (nëse është ndryshe)
<b>WSDL</b>	Gjuha e përshkrimit të shërbimeve Web (Web Service) – gjuhë e bazuar në XML për përshkrimin e funksioneve të ofruara nga një shërbim WWW, siç specifikohet në <a href="http://www.w3.org/TR/wsdl">http://www.w3.org/TR/wsdl</a>	-
<b>XML Schema</b>	Gjuhë e bazuar në XML që ka si qëllim përkufizimin e strukturës së dokumentit XML, siç specifikohet në <a href="http://www.w3.org/TR/xmlschema11-1/">http://www.w3.org/TR/xmlschema11-1/</a> Dhe në <a href="https://www.w3.org/TR/xmlschema11-2/">https://www.w3.org/TR/xmlschema11-2/</a>	-

Tabela 1 – Shkurtime

## 1.2 TERMINOLOGJIA

Termi	Përkufizimi	Terminologjia e përdorur në Ligj (nëse është ndryshe)
<b>Mesazhi i të dhënave të përgjigjes</b>	Një strukturë e të dhënave në një format të përcaktuar të përshkruar nga autoriteti përgjegjës, që përmban Numrin identifikues të veçantë të faturës (NIVF) dhe përdoret si njohje e faturës dhe korrektësisë formale të mesazhit të regjistruar të faturave të regjistruara të dërguara.	Një strukturë e të dhënave në një format të përcaktuar të përshkruar nga autoriteti përgjegjës, e cila përmban identifikues të veçantë të faturës (UII) dhe përdoret si njohje e faturës dhe korrektësisë zyrtare të mesazhit të regjistruar të të dhënave të faturave të dërguara.
<b>Mesazhi i të dhënave të gabimit</b>	Një strukturë e të dhënave në një format të përcaktuar të përshkruar nga autoriteti përgjegjës, e cila përmban një kod gabimi dhe përshkrimin e tekstit të tij si reagim ndaj një mesazhi të regjistruar të faturave të marra që përmban gabime që parandalojnë përpunimin e tij, ose kur ndodh një gabim tjetër që parandalon mesazhin duke u përpunuar nga ana e organit tatimor.	-
<b>Fatura</b>	Një faturë është një provë e shitjes (në formë letre ose elektronike) e lëshuar nga një tatimpagues një personi ose subjekti që bën një blerje, e cila përmban të gjitha informacionet në lidhje me shumat e artikujve të shitjes.  Faturë nënkupton çdo dokument të lëshuar në letër ose në formë elektronike, i cili plotëson kërkesat e parashikuara në Projekt Ligjin "PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT"	-
<b>Lëshuesi i faturës</b>	Personi që po lëshon faturën. Lëshuesi i faturës është përgjegjës për fiskalizimin e faturës në CIS. Ky person është në shumicën e rasteve shitësi i mallrave apo shërbimeve, por në rast të faturës së vetë-faturuar, lëshuesi është blerësi i mallrave apo shërbimeve.	-
<b>Fatura e regjistruar</b>	Faturë që është e regjistruar në Sistemin Qendror të Faturave dhe përmban "Numri identifikues të veçantë të faturës" (NIVF).	Faturë e regjistruar në Platformën Qendrore të Faturave që përmban UII.
<b>Mesazhi i të dhënave të faturës së regjistruar</b>	Një strukturë e të dhënave në një format të përcaktuar të përshkruar nga autoriteti përgjegjës, i cili përmban informacione në lidhje faturën dhe informacione të tjera teknike të nevojshme. Ky është një mesazh XML që përmban informacionin e përshkruar në standardet përkatëse të Web service: SOAP / WSDL / WS-Security, etj. Një mesazh i të dhënave të faturave të regjistruara dërgohet nga një pajisje faturimi në sistemin qendror të	-



Termi	Përkufizimi	Terminologjia e përdorur në Ligj (nëse është ndryshe)
	administratës tatimore.	
<b>Platforma Qendrore e Faturave</b>	Platforma Qendrore e Faturave është një aplikacion në internet për tatimpaguesit, që ofron mbështetje për proceset e fiskalizimit të faturave.	-
<b>Arka e tatimpaguesit/pajisja elektronike e faturimit</b>	Një pajisje e tatimpaguesit, e cila dërgon informacione mbi faturat e regjistruara në autoritetin tatimor. Kjo mund të nënkuptojë, në varësi të përmbledhjes, një pajisje fundore, si arkë, ose SW dhe HW shtesë që në të vërtetë dërgojnë informacionin e regjistruar të faturave. Mesazhet e të dhënave përfshijnë një artikull të shënuar si " ID e Arkës ", i cili identifikon shërbimin përfundimtar (arkën). Në pjesët e tjera të tekstit, ky term zakonisht nënkupton pajisjen përfundimtare dhe SW dhe HW përkatëse që i dërgojnë mesazhet e të dhënave.	-

Tabela 2 - Terminologjia

## 2. Mjediset

Qeveria do të publikojë adresat e shërbimit në internet (Web service) për dy lloje të mjedisëve: mjedisi i punës (production environment) dhe një ose më shumë mjedise testimi:

- **Mjedisi Provë/Test** do të përdoret vetëm nga zhvilluesit e programeve kompjuterike (zhvillimi i softuerit për fiskalizimin e faturave me para në dorë), jo nga përdoruesit fundorë të arkave. Dërgimi i një mesazhi të të dhënave në mjedisin test nuk konsiderohet dërgimi i informacionit të regjistruar të faturës. NIVF i kthyer nga mjedisi test nuk është një NIVF i vlefshëm (është i ndryshëm në parashtesë(prefix)). Në mjedisin test, certifikatat elektronike për arkat mund të lëshohen duke përdorur një proces të thjeshtuar nga AKSHI.
- **Mjedisi i Punës (production environment)** është i destinuar për tatimpaguesit dhe do të përdoret për aktivitetin e zakonshëm, d.m.th. marrjen dhe pranimin e mesazheve të të dhënave që përmbajnë informacione mbi shitjet e regjistruara.

Pika e aksesit:

- o Mjedisi provë/test:
  - o <https://eFiskalizimi-test.tatime.gov.al/FiscalizationService-v2/FiscalizationService.wsdl>
- o Mjedisi i punës:
  - o <https://eFiskalizimi.tatime.gov.al/FiscalizationService-v2/FiscalizationService.wsdl>

### 2.1 PUNA PËRGATITORE PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMIT TË FISKALIZIMIT

Detaje për këtë çështje mund të gjenden në specifikimet funksionale, kapitulli që mbulon këtë temë. Më poshtë është diagrama e procesit.




Figura 1 – Aktivitetet përgatitore për përdorimin e shërbimit fiskal

## 2.2 TOPOLOGJIA

Përdoruesit aksesojnë Platforma Qendrore e Faturave duke filluar lidhjen e sigurtë (Transport Layer Security - TLS) me një drejtim. Klientët shkëmbejnë mesazhe me pikën e aksesit të Administratës Tatimore duke përdorur kanalin e sigurt TLS sipas procedurës së përshkruar. Shkëmbimi i të dhënave është sinkron, që do të thotë se pika e aksesit përgjigjet menjëherë në bazë të kërkesës së përdoruesit. Format e mesazheve të kërkesës dhe përgjigjes specifikohen përmes skemës XML.

### 2.2.1 Pika e aksesit të Platformës Qendrore të Faturave (CIS)

Zbatimi dhe mirëmbajtja e pikës së hyrjes është detyrë e DPT. DPT do t'u mundësojë përdoruesve lidhjen me pikën e hyrjes në dy mjediset: punës dhe testimit.

### 2.2.2 Lidhja e internetit

Pika e hyrjes vihet në funksion nëpërmjet lidhjeve të internet në protokollin HTTPS.

### 2.2.3 Sistemi i informacioni të klientit

Klientët janë të detyruar të ofrojnë mbështetje harduerike dhe softuerike për shkëmbimin e mesazheve me pikën e hyrjes. Siç tregohet në figurën më poshtë, nuk është planifikuar zhvillimi i komponentëve ndërmjetësues. Zhvillimi i zgjidhjeve harduer-softuer është në fushën e biznesit të klientit. Klienti është gjithashtu i detyruar të sigurojë lidhjen e internetit në pikën e hyrjes së CIS me gjerësi të bandës së nevojshme. Zgjedhja e platformës dhe zbatimi i zgjidhjes së softuerëve është pjesë e zgjidhjes së klientit dhe informacioni i tillë nuk është i nevojshëm për t'ia dhënë DPT.




Figura 2 – Sistemi i informacionit i klientit

## 2.3 KUSHTET PËR LIDHJEN ME PLATFORMËN QËNDRORE TË FATURAVE (CIS)

Sistemi qendror i faturave (CIS) i Administratës Tatimore do të jetë i disponueshëm në dy mjedise: punës dhe testimit. Kushtet e lidhjes janë të ngjashme, por ndryshojnë në adresat e pikave të tyre të hyrjes dhe certifikatave. Për të dy mjediset, atë të punës dhe testimit, dy çertifikata të ndryshme lëshohen nga AKSHI. Mjedisi nuk është i ndryshëm në funksionalitetin e tij (përveç zhvillimit të ri të funksionaliteteve), vetëm ndryshimi qëndron tek të dhënat - ambienti i testit, i cili përdor të dhëna test.

### 2.3.1 Parakushtet dhe rekomandimet e rrjetit

Për t'u lidhur me CIS e Administratës Tatimore, sistemi i klientit ka nevojë të përmbushë këto kushte:

Lloji i rrjetit	Internet
Rekomandohen porta te hapura TCP për CIS-ën	443

Rekomandimet e rrjetit për sistemin e klientit janë:

Karakteristikat e link-ut	Link permanent simetrik
BandWidth	2 Mb/s në minimum (deri ne 40 mesazhe për sekondë, duke menduar se një mesazh zë 6 KB)

### 2.3.2 Parakushtet e sigurisë

I gjithë komunikimi me Sistemin Qendror të Faturave të Administratës Tatimore mbrohet nga kriptimi 1-drejtisor TLS në shtresën e transportit. Në mjedisin e punës të Platformës Qendrore të Faturave i paraqitet klientit një certifikatë TLS e lëshuar nga AKSHI, pune CA (AC-Autoritetin e Certifikimit), ndërsa në mjedisin e provës çertifikata lëshohet nga AKSHI, testi CA (Autoriteti i Certifikimit).

Mbrojtja në shtresën e transportit	HTTPS (TLS v1.1 and v1.2, AES_256 encryption at least)
Certifikatat për nënshkrimet elektronike	Lloji i certifikatës: Certifikatë aplikimi digjitale për fiskalizimin

### 2.3.3 Parakushtet e zbatimit

Funksionaliteti i CIS është në dispozicion të klientëve të tij duke përdorur teknologjinë e shërbimit në internet. Kjo është arsyeja që zbatimi nga ana e klientit (ose infrastruktura, në varësi të realizimit) duhet të plotësojë këto parakushte:

Standardet për klientin	WS-1
Lloji i shërbimit	Document-literal
Protokolli i zbatimit	SOAP/HTTPS (SOAP 1.1)
Kodi i site i mesazhit të kërkuar XML	UTF-8

### 3. NDËRFAQJA

Ndërfaqja për shkëmbimin e të dhënave midis tatimpaguesit dhe CIS (Platformën Qendrore të Faturave) në lidhje me fiskalizimin do të jetë SOAP web service. Mesazhet janë në format XML sipas standardeve të mesazheve SOAP.

Web service ka disa operacione të cilat do të përdoren nga tatimpaguesi që ka nevojë të bëjë fiskalizimin e faturave. Faturat lëshohen nga pajisja elektronike e faturimit e përfaqësuar nga kodi i saj. Kodi caktohet në funksion të regjistrimit të pajisjes elektronike të faturimit, e cila duhet të ekzekutohet gjatë instalimit të secilës pajisje elektronike të faturimit. Në fillim të çdo dite pune, pajisja elektronike e faturimit, e cila merret me transaksione me para në dorë duhet të regjistrojë sasinë e parave cash në depozitë/arkë dhe vetëm atëherë duhet të fillojë të lëshojë fatura. Çdo faturë duhet të regjistrohet në shërbimin e fiskalizimit dhe pas regjistrimit të suksesshëm, faturës i caktohet NIVF e cila printohet në faturë. Në rast se fatura duhet të korrigjohet, lëshohet faturë e re korrigjuese duke iu referuar faturës e cila duhet të korrigjohet. Kjo faturë e re korrigjuese përshkruan gjendjen e re të ndryshuar përfundimtare dhe jo ndryshimet nga fatura origjinale. Gjatë ditës, pajisjet elektronike të faturimit për transaksione me para në dorë duhet të regjistrojnë gjendjen aktuale të parave të cash (rekomandohet ta bëni atë kur operatorët e pajisjes elektronike të faturimit ndryshojnë), si dhe çdo tërheqje ose depozitim të parave cash në pajisjen elektronike të faturimit. Secili prej këtyre operacioneve shpjegohet në kapitullin përkatës së bashku me listën e elementeve të mesazheve të duhen shkëmbyer.

Tatimpaguesit gjithashtu duhet të regjistrojnë faturat shoqëruese për të gjitha mallrat e transferuara ndërmjet magazinave apo vendeve të ushtrimit të aktivitetit të biznesit dhe ambienteve të shitjes brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në rrethana të specifikuara nga Ligji "Për faturën dhe sistemin për monitorimin e transaksioneve" dhe akteve nënligjore të tij.

Mesazhi i dërguar nga tatimpaguesi në CIS është mesazhi i kërkesës, së cilës CIS i përgjigjet duke dërguar mesazhin e përgjigjes. Në rast të një gabimi, mesazhi i gabimit dërgohet në përgjigje me strukturën e tij të përcaktuar. Mesazhet e kërkesave dhe përgjigjeve (me përjashtim të mesazhit të gabimit) të gjitha kanë këto pjesë: header (informacion i përgjithshëm për mesazhin), të dhëna (të dhëna specifike për operacionin), nënshkrim (nënshkrim elektronik, nënshkruar nga tatimpaguesi që po dërgon mesazhin, i cili siguron identitetin e dërguesit dhe informacionin për të verifikuar se të dhënat e mesazhit nuk janë ndryshuar). Nënshkrimi shpjegohet në kapitullin 4.3.

#### 3.1 VERSIONIMI I NDËRFAQES

Versioni i shërbimit të fiskalizimit do të bazohet në skemën e versionimit semantik. Çdo version ka një numër versioni të caktuar të shprehur si "MAJOR.MINOR.PATCH", secila prej të cilave është me numër të plotë të rritur sipas këtyre rregullave:

- Versioni MAJOR rritet kur ka ndryshime të papajtueshme të API-së. Do të sigurohet ndërfaqja e re, dhe ndërfaqja e vjetër do të mbetet për njëfarë kohe. Klientët pritet të përditësohen me versionin e ri siç përshkruhet në përshkrimet e shënimeve të versionit të ri.
- Versioni MINOR rritet kur një funksionalitet shtohet në mënyrë të pajtueshme. Ndërfaqja aktuale mbetet e përshtatshme me klientët aktualë, por janë shtuar funksione të reja, të cilat mund ose duhet të përdoren. Klientët pritet të përditësohen në versionin e ri siç përshkruhet në përshkrimet e shënimeve të versionit të ri.

- Versioni PATCH rritet kur ka rregullime të gabimeve me pas-pajtueshmërinë (backwards-compatible). Ndërfaqja aktuale mbetet e njëjtë.

Pika e aksesit të shërbimit do të ketë një prapashtesë konteksti -vMAJOR, p.sh. / FiscalizationService-v2. Kjo do të thotë që në një moment mund të ketë disa pika përfundimi të shërbimit aktiv me versione të ndryshme MAJOR, por secila prej tyre do të ketë gjithnjë versionet e fundit MINOR dhe PATCH.

## 3.2 KODIMI I MESAZHIT TË TË DHËNAVE

Të gjithë elementët në të gjitha mesazhet e të dhënave do të përdorin vetëm karakteret e zgjedhura të koduara si një byte i vetëm në një seri standarde të karakterit dhjetor ASCII. Kodet dhjetore të lejuara janë 9, 10, 13 ose 32 deri në 126.

UTF-8 duhet të përdoret për kodimin e mesazheve të të dhënave si dokumente XML, d.m.th rreshti i parë i paketës XML SOAP gjithmonë do të jetë:

```
<?xml version="1.0" encoding="UTF-8"?>
```

Të gjithë elementët XML të shërbimit të fiskalizimit janë pjesë e së njëjtës “namespace”, referuar në përkufizimin e Web service (WSDL).

Maska e formatit të të dhënave për artikujt individualë, e cila është renditur së bashku me përshkrimin e hollësishëm të tyre më poshtë, është një shprehje e rregullt në kuptimin e Skemës XML, e cila përcakton sintaksën e kërkuar të artikullit të dhënë.

## 3.3 STRUKTURA E MESAZHIT TË TË DHËNAVE

Të gjitha llojet e mesazheve të të dhënave kanë një format të përbashkët të të dhënave bazuar në protokollin SOAP 1.1 (Simple Object Access Protocol), d.m.th. aplikacionet me strukturë të dhënash XML futen në trupin e paketës (envelope) SOAP, ndryshe nga titulli (header) i paketës (envelope) SOAP, e cila mbetet bosh.

Çdo mesazh i të dhënave për kërkesën dhe përgjigjen nënshkruhet me një çelës privat, që i përket respektivisht lëshuesit ose shërbimit të fiskalizimit. Përrashtim nga rregulli janë mesazhet e gabimit (të përshkruara në kapitullin 3.7.6) të cilat nuk janë nënshkruar nga shërbimi i fiskalizimit.

Nënshkrimi elektronik llogaritet vetëm për mesazhin e të dhënave brenda elementit të trupit të paketës SOAP dhe është i përfshirë brenda këtij mesazhi të të dhënave si një element nënshkrimi paketës XML.

## 3.4 KONTROLLE

Ka tre lloje kontrollesh:

- Kontroll i detyrueshëm (në kohë reale)
- Kontrolle shtesë (në një kohë të dytë(verifikimi i back-up))

Kontrollet e detyrueshme kryhen nga Platforma Qendrore të Faturave për të gjitha metodat në kohë reale. Nëse kontrolli nuk kalon me sukses, një mesazh gabimi do të kthehet me një kod gabimi të përcaktuar në të. Kontrollet e detyrueshme përfshijnë si më poshtë:

Emri i kontrollit	Përshkrimi i Kontrollit	Kodi i gabimit
-------------------	-------------------------	----------------

Formatim XML	Formatim XML duhet të jetë i vleshëm	0.20
Kontroll i madhësisë së të dhënave	Madhësia nuk duhet të kalojë 150kB	1
Validimi i strukturës XML	Kontrollohet mesazhi i të dhënave të regjistruara të faturës individuale në XML, krahasuar me skemën XSD (* .xsd). Skema XSD përmban përkufizimin e saktë të të dhënave dhe formatit të strukturës për të dhënat e artikujve individualisht dhe një kontroll të pranisë së këtyre artikujve.	11
Validimi i Certifikatës	Kontrollohet nëse certifikata ka skaduar. Kontrollohet që Certifikata është lëshuar nga Autoriteti i Certifikimit i besueshëm. Kontrollohet nëse numri i identifikimit të tatimpaguesit në certifikatë korrespondon me numrin e identifikimit të lëshuesit të faturës (NIPT) në mesazhin XML. Kontrollohet që certifikata të mos jetë e listuar në CRL	34, 35, 36, 37, 38, 39
Kontrollo nënshkrimin elektronik	Kontrollohet që mesazhi “hash” i llogaritur nga Platforma Qendrore e Faturave korrespondon me atë të listuar në mesazh. Kontrollohet nëse nënshkrimi korrespondon me “hash” e mesazhit dhe me celësin publik të certifikatës.	22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34
Koha e klientit ndryshon	Koha e klientit ndryshon nga koha e një serveri për më shumë se koha e lejuar në minuta	2
Kontrolle të tjera	Kontrollet e tjera siç janë specifikuar në dokumentin e specifikimeve funksionale dhe qëllime kontrolli të Administratës Tatimore	

Tabela 3

Kontrollet shitesë nuk kryhen në momentin e regjistrimit të faturës, por përkundrazi shtyhen për përpunimin e mëvonshëm të faturave. Gabimet e zbuluara këtu do të jenë në dispozicion të tatimpaguesit mbi Platformën qendrore të faturave dhe për zyrtarët e tatimeve përmes CPCM.

### 3.5 REGJISTRIMI I TCR-SË (ARKËS) SË RE

Secila pajisje elektronike e faturimit duhet të regjistrohet në CIS në mënyrë që të marrë kodin, që përfaqëson atë pajisje elektronike të faturimit. Ky kod përdoret për identifikimin e pajisjes elektronike të faturimit në mesazhet që shkëmbehen midis CIS dhe pajisjes elektronike të faturimit. Ky regjistrim duhet të bëhet vetëm një herë kur pajisja elektronike e faturimit është instaluar në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, ku përdoret.

Para kësaj, tatimpaguesi duhet të regjistrohet në Regjistrin Aktiv të Tatimpaguesëve të Administratës Tatimore. Tatimpaguesi gjithashtu duhet të regjistrojë vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit (në aplikacionin Platforma Qendrore e Faturave) në të cilën ndodhet pajisja elektronike e faturimit para regjistrimit të saj.

Nëse ky regjistrim është bërë për të njëjtin identifikim të brendshëm të TCR dhe Kodin të njesisë së biznesit (vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit), CIS do të përditësoj informacionin me të dhëna të reja që ndodhen në mesazhin e kërkesës dhe do të kthejë të njëjtin TCRCode. Çregjistrimi është i mundur duke përdorur fushën e re “ValidTo” të të dhënave në mesazhin e “RegisterTCRrequest”.




Figura 3 – Regjistrimi i arkës së tatimpaguesit

### 3.5.1 Mesazhi i kërkesës për regjistrimin e arkës së tatimpaguesit

Emri	Lloji i fushës	Ngjarja [Min, Max]	Përshkrimi
RegisterTCRRequest	Element	[1, 1]	Elementi XML që përfaqëson regjistrimin e TCR
Id	Atributte	[1, 1]	Atributi i përdorur për krijimin e nënshkrimit dhe verifikimit. Vlera fikse "Request"
Version	Atributte	[1, 1]	Atributi i përdorur për specifikimin e pajtueshmërisë me skemë XSD. Për këtë version vlera fikse është "2".
Header	Element	[1, 1]	Elementi XML që përfaqëson header (titulin)
UUID	Attribute	[1, 1]	ID e mesazhit
SendDateTime	Attribute	[1, 1]	Data dhe ora e dërgimit të mesazhit në Administratën Tatimore
TCR	Element	[1, 1]	Elementi XML që përfaqëson një mesazh të vetëm regjistrimi të arkës
IssuerNUIS	Attribute	[1, 1]	NUIS/NIPT i tatimpaguesit
BusinUnitCode	Attribute	[1, 1]	Kodi njesisë (vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit) së biznesit
TCRIntID	Attribute	[1, 1]	Identifikimi i brendshëm i TCR
SoftCode	Attribute	[0,1]	Kodi i softuerit i përdorur nga TCR
MantainerCode	Attribute	[0,1]	Kodi i mirëmbajtësit të softuerit të TCR
ValidFrom	Attribute	[0,1]	Data nga kur do të mund të përdoret TCR
ValidTo	Attribute	[0,1]	Data deri kur do të mund të përdoret TCR
Signature	Element	[1, 1]	Elementi XML me nënshkrimin elektronik



Tabela 4

### 3.5.1.1 Header

Element që paraqet titullin e mesazhit të të dhënave të kërkesës.

### 3.5.1.2 Header UUID

Element i gjeneruar nga Pajisja elektronike e Faturimit (TCR) e tatimpaguesit. Në mënyrë unike identifikon mesazhin e kërkesës të dërguar nga TCR-ja në CIS. UUID (Identifikuesi Unik Universal) duhet të ndërtohet sipas RFC4122, versioni 4.

Lloji i të dhënave	String
Gjatësia	36 karaktere
Modeli	[0-9a-fA-F]{8}-[0-9a-fA-F]{4}-[1-5][0-9a-fA-F]{3}-[89abAB][0-9a-fA-F]{3}-[0-9a-fA-F]{12}
Shembulli	58e0a7d7-eebc-41d8-9669-0800200c9a66 58E0A7D7-EEBC-41D8-9669-0800200C9A66

Tabela 5

### 3.5.1.3 Header SendDateTime

Elementi që paraqet datën dhe orën e dërgimit të mesazhit të kërkesës në CIS. Data dhe ora duhet të jenë në formatin ISO 8601.

Lloji i të dhënave	dateTime
Gjatësia	23 karaktere
Modeli	[0-9]{4}-[0-9]{2}-[0-9]{2}T[0-9]{2}:[0-9]{2}:[0-9]{2}[+-][0-9]{2}:[0-9]{2}
Shembulli	2019-01-24T22:00:58+01:00 2019-01-24T22:00:58-01:00

Tabela 6

### 3.5.1.4 TCR

Element që paraqet një kërkesë të vetme regjistrimi të TCR-së së tatimpaguesit.

### 3.5.1.5 TCR IssuerNUIIS

Element që paraqet NIPT(NUIS) e lëshuesit të faturës.

Lloji i të dhënave	String
Gjatësia	10 karaktere
Modeli	[a-zA-Z]{1}[0-9]{8}[a-zA-Z]{1}
Shembulli	K72001008V

Tabela 7

### 3.5.1.6 TCR BusinUnitCode

Kodi i njesisë (vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit) së biznesit me të cilën fatura është lëshuar.

Lloji i të dhënave	String
--------------------	--------

Gjatësia	10 karaktere
Modeli	[a-z]{2}[0-9]{3}[a-z]{2}[0-9]{3}
Shembulli	ab123ab123

Tabela 8

### 3.5.1.7 TCR TCRIntID

Atributi që paraqet identifikuesin e brendshëm të TCR-së.

Lloji i të dhënave	String
Gjatësia	50 karaktere
Shembulli	2

Tabela 9

### 3.5.1.8 TCR SoftCode

Kodi i softuerit të përdorur për lëshimin e faturës.

Lloji i të dhënave	String
Gjatësia	10 karaktere
Modeli	[a-z]{2}[0-9]{3}[a-z]{2}[0-9]{3}
Shembulli	ab123ab123

Tabela 10

### 3.5.1.9 TCR MaintainerCode

Kodi i mirëmbajtësit të softuerit të përdorur në TCR.

Lloji i të dhënave	String
Gjatësia	10 karaktere
Modeli	[a-z]{2}[0-9]{3}[a-z]{2}[0-9]{3}
Shembulli	ab123ab123

Tabela 11

### 3.5.1.10 TCR ValidFrom

Elementi paraqet datën nga e cila do të mund të përdoret TCR-ja ose ajo është e vlefshme.

Lloji i të dhënave	Datë
Gjatësia	10 karaktere
Modeli	[0-9]{4}-[0-9]{2}-[0-9]{2}
Shembulli	2019-01-24

Tabela 12

### 3.5.1.11 TCR ValidTo

Elementi paraqet datën deri në të cilën TCR-ja do të mund të përdoret ose ajo është e vlefshme.

Lloji i të dhënave	Datë
Gjatësia	10 karaktere
Modeli	[0-9]{4}-[0-9]{2}-[0-9]{2}
Shembulli	2019-01-24

Tabela 13

### 3.5.1.12 Signature

Element XML që ruan nënshkrimin elektronik të paketuar të përshkruar në kapitullin 4.3.1.

## 3.5.2 Mesazhi i përgjigjes me të dhëna për regjistrimin e TCR

Emri	Lloji i fushës	Ngjarja [Min, Max]	Përshkrimi
RegisterTCRResponse	Element	[1, 1]	Element XML që paraqet regjistrimin e arkës
Id	Attribute	[1, 1]	Atribut i përdorur për krijimin dhe verifikimin e nënshkrimit. Vlera fikse "Response"
Version	Attribute	[1, 1]	Atribut i përdorur për të specifikuar pajtueshmërinë me skemën XSD. Për këtë version vlera fikse është "2".
Header	Element	[1, 1]	Elementi XML që paraqet header (titullin)
UUID	Attribute	[1, 1]	ID e mesazhit
RequestUUID	Attribute	[1, 1]	UUID (Identifikuesi Unik Universal) i mesazhit të kërkesës për të cilën është dërguar mesazhi i përgjigjes
SendDateTime	Attribute	[1, 1]	Data dhe ora e dërgimit të mesazhit nga Administrata Tatimore
TCRCode	Element	[1, 1]	Kodi i TCR i gjeneruar nga CIS
Signature	Element	[1, 1]	Elementi XML me nënshkrim

Tabela 14

### 3.5.2.1 Header

Element që përfaqëson titullin e mesazhit të të dhënave të përgjigjes.

#### 3.5.2.1.1 Header UUID

Element i gjeneruar nga CIS. Në mënyrë unike identifikon mesazhin e përgjigjes të dërguar nga CIS në TCR. UUID duhet të ndërtohet sipas RFC4122, versioni 4.

Lloji i të dhënave	String
Gjatësia	36 karaktere
Modeli	[0-9a-fA-F]{8}-[0-9a-fA-F]{4}-[1-5][0-9a-fA-F]{3}-[89abAB][0-9a-fA-F]{3}-[0-9a-fA-F]{12}
Shembulli	58e0a7d7-eebc-41d8-9669-0800200c9a66 58E0A7D7-EEBC-41D8-9669-0800200C9A66

Tabela 15

### 3.5.2.1.2 Header RequestUUID

Element i gjeneruar nga TCR e tatimpaguesit dhe referuar nga CIS. Identifikon mesazhin e kërkesës në mënyrë unike, për të cilën mesazhi i përgjigjes i dërgohet TRC-së së tatimpaguesit. UUID duhet të ndërtohet sipas RFC4122, versioni 4.

Lloji i të dhënave	String
Gjatësia	36 karaktere
Modeli	[0-9a-fA-F]{8}-[0-9a-fA-F]{4}-[1-5][0-9a-fA-F]{3}-[89abAB][0-9a-fA-F]{3}-[0-9a-fA-F]{12}
Shembulli	58e0a7d7-eebc-41d8-9669-0800200c9a66 58E0A7D7-EEBC-41D8-9669-0800200C9A66

Tabela 16

### 3.5.2.1.3 Header SendDateTime

Elementi paraqet datën dhe orën e dërgimit të mesazhit të përgjigjes në TCR-në e tatimpaguesit. Data dhe ora duhet të jenë në formatin ISO 8601.

Lloji i të dhënave	dateTime
Gjatësia	23 karaktere
Modeli	[0-9]{4}-[0-9]{2}-[0-9]{2}T[0-9]{2}:[0-9]{2}:[0-9]{2}[+-][0-9]{2}:[0-9]{2}
Shembulli	2019-01-24T22:00:58+01:00 2019-01-24T22:00:58-01:00

Tabela 17

### 3.5.2.2 TCRCode

Kodi i Pajisjes Elektronike të Faturimit(TCR) së tatimpaguesit, i gjeneruar nga Platforma Qendrore e Faturave(CIS).

Lloji i të dhënave	String
Gjatësia	10 karaktere
Modeli	[a-z]{2}[0-9]{3}[a-z]{2}[0-9]{3}
Shembulli	ab123ab123

Tabela 18

### 3.5.2.3 Signature

Element XML që ruan nënshkrimin elektronik të paketuar të përshkruar në kapitullin 4.3.1.

## 3.5.3 Kontrollat e detyrueshme

Kontrollet e detyrueshme do të kryhen nga Platforma Qendrore të Faturave (CIP) në procesin e regjistrimit të Pajisjes Elektronike të Faturimit (TCR) së re të tatimpaguesit. Në rast se kontrolli nuk kalon, një mesazh gabimi do të kthehet me kod gabimi të përcaktuar.

Pas identifikimit të një gabimi kritik, CIS do t'i kthejë një mesazh gabimi të dhënash që përmban kodin numerik të gabimit dhe përshkrimin të tekstit të tij. (shiko kapitullin 3.9). Kur identifikohen gabimet që sistemi i interpreton si sulm kibernetik, sistemi nuk i dërgon përgjigje klientit (Pajisjes Elektronike të Faturimit të tatimpaguesit). Kontrollet e detyrueshme përfshijnë të gjitha kontrollet nga kapitulli 3.4 si më poshtë:

Emri i kontrollit	Përshkrimi i kontrollit	Kodi i gabimit
I vleshëm nga (valid from) në të kaluarën	TCR.ValidFrom nuk mund të jetë në të kaluarën	45
I vleshëm deri (valid to) në të kaluarën	TCR.ValidTo nuk mund të jetë në të kaluarën	46
I vleshëm deri (valid to) përpara i vleshëm nga (valid from)	TCR.ValidTo nuk mund të jetë përpara TCR.ValidFrom.	47
TCR Aktive i vleshëm nga (valid from) ndryshohet	TCR.ValidFrom i ndryshëm nga TCR aktive "valid from". Vlera e "valid from" TCR aktive nuk mund të ndryshojë.	48
Tatimpaguesi i regjistruar	TCR.IssuerNUIS nuk i referohet tatimpagues aktiv në Regjistrin e tatimpaguesve.	52
Njesia e biznesit të regjistruar	TCR.BusinUnitCode nuk i referohet njesisë së biznesit aktiv (vendit të ushtrimit të veprimtarisë aktiv të biznesit) të tatimpaguesit.	41
Softueri i regjistruar	Kodi i mirëmbajtësit i referohet softuerit aktiv	42
Mirëmbajtësi i regjistruar	TCR.MaintainerCode nuk i referohet mirëmbajtësit aktiv të softuerit	43

Tabela 19

### 3.5.4 Mesazhi i gabimit

Mesazhi i gabimit përcaktohet në kapitullin 3.9.

### 3.5.5 Shembull XML

#### 3.5.5.1 Kërkesë XML

```
<SOAP-ENV:Envelope xmlns:SOAP-ENV="http://schemas.xmlsoap.org/soap/envelope/">
  <SOAP-ENV:Header/>
  <SOAP-ENV:Body>
    <RegisterTCRRequest xmlns="https://eFiskalizimi.tatime.gov.al/FiscalizationService/schema" xmlns:ns2="http://www.w3.org/2000/09/xmldsig#" Id="Request">
      <Header SendDateTime="2019-09-03T14:37:31+02:00" UUID="688b3a2d-bcdf-4410-b76f-6088d2792923"/>
      <TCRBusinUnit="bb123bb123" IssuerNUIS="I12345678I" ManufacNum="mm123mm123" RegDateTime="2019-09-03T14:37:31+02:00" SoftNum="ss123ss123" TCROrdNum="1"/>
      <Signature xmlns="http://www.w3.org/2000/09/xmldsig#">
        <SignedInfo>
          <CanonicalizationMethod Algorithm="http://www.w3.org/2001/10/xml-exc-c14n#" />
          <SignatureMethod Algorithm="http://www.w3.org/2001/04/xmldsig-more#rsa-sha256" />
          <Reference URI="#Request">
            <Transforms>
              <Transform Algorithm="http://www.w3.org/2000/09/xmldsig#enveloped-signature" />
              <Transform Algorithm="http://www.w3.org/2001/10/xml-exc-c14n#" />
            </Transforms>
            <DigestMethod Algorithm="http://www.w3.org/2001/04/xmldsig#sha256" />
            <DigestValue>ynd8aMSVvaXJ1f+z4vDLNsh0ncLySyhs1vdt7EIHbc=</DigestValue>
          </Reference>
          <SignedInfo>
            <SignatureValue>m74RG/UMsv3g9NyIT2+Tfk5.....aaAdB1a23V1HIJk6PKTL6nBy7a5r0Q5K8LXDug==</SignatureValue>
          <KeyInfo>
            <X509Data>
              <X509Certificate>MIIE6TCCATGgAwIBAgICEA8wDQ.....uoqWsSuLmA==</X509Certificate>
            </X509Data>
          </KeyInfo>
        </SignedInfo>
      </RegisterTCRRequest>
    </SOAP-ENV:Body>
  </SOAP-ENV:Envelope>
```

### 3.5.5.2 Përgjigje XML

```
<env:Envelope xmlns:env="http://schemas.xmlsoap.org/soap/envelope/">
<env:Header/>
<env:Body>
<RegisterTCRResponseId="Response" xmlns="https://efiskalizimi.tatime.gov.al/FiscalizationService/schema" xmlns:ns0="http://www.w3.org/2000/09/x
mldsig#">
<TCRNumber>cc123cc123</TCRNumber>
<Signature xmlns="http://www.w3.org/2000/09/xmldsig#">
<SignedInfo>
<CanonicalizationMethod Algorithm="http://www.w3.org/2001/10/xml-exc-c14n#" />
<SignatureMethod Algorithm="http://www.w3.org/2001/04/xmldsig-more#rsa-sha256" />
<Reference URI="#Response">
<Transforms>
<Transform Algorithm="http://www.w3.org/2000/09/xmldsig#enveloped-signature" />
<Transform Algorithm="http://www.w3.org/2001/10/xml-exc-c14n#" />
</Transforms>
<DigestMethod Algorithm="http://www.w3.org/2001/04/xmldsig-more#sha256" />
<DigestValue>eynN18M9tC3pGxVNEURb6MGrbw9HrSIy1Iso64gaIsE=</DigestValue>
</Reference>
</SignedInfo>
<SignatureValue>q0giTP5LgtELhdG0J1Ff0tIIEU.....YumiyWZKQ5o3eyRQ/kB8UJywbNMaw=</SignatureValue>
<KeyInfo>
<X509Data>
<X509Certificate>MIIF0TCCAYGgAwIBAgICEAwDQVJ.....FbRiruyYIHYKTCznxUZu25Q/hsah</X509Certificate>
</X509Data>
</KeyInfo>
</Signature>
</RegisterTCRResponse>
</env:Body>
</env:Envelope>
```

## 3.6 REGJISTRIMI I GJENDJES FILLESTARE TË PARAVE CASH NË TCR

Çdo ditë, para regjistrimit të faturës së parë të ditës së punës në CIS, çdo TCR për trajtimin e transaksioneve me para në dorë duhet të regjistrojë gjendjen fillestare të shumës së parave cash (Operacioni INITIAL). Nëse është e nevojshme, arka(TCR) mund të korrigjojë gjendjen fillestare duke regjistruar përsëri shumën e parave cash (Operacioni INITIAL).

Gjatë ditës, operatori mund të shtojë ose të tërheqë para cash nga TCR dhe secila prej këtyre veprimeve duhet të regjistrohet (Operacioni INOUT).

Në raste të veçanta të përcaktuara nga Ligji (kur ka dështim të lidhjes në internet ose nëse tatimpaguesi operon në zonë pa lidhje interneti), informacioni për gjendjen fillestare, shtimin ose tërheqjen duhet të ruhet në memorjen TCR. Nëse ka dështim të TCR, të dhënat e shtimit / tërheqjes shkruhen në bllokun e veçantë të faturave dhe i dorëzohen Administratës Tatimore më vonë së bashku me të gjitha faturat që do të fiskalizohen gjatë këtij procesi.

Gjendja fillestare e parave cash në arkë mund të jetë 0.00 lekë.

Regjistrimi i gjendjes fillestare të parave cash nuk kërkohet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit që operon vetëm me fatura për transaksione pa para në dorë ose në rastin e blerjeve online (me anë të Internetit – web-shop).




Figura 4 – Regjistrimi i gjendjes së parave cash në arkë

### 3.6.1 Mesazhi i kërkesës për regjistrimin e gjendjes fillestare të arkës

Emri	Lloji i fushës	Ngjarja [Min, Max]	Përshkrimi
RegisterCashDepositRequest	Element	[1, 1]	Elementi root XML që përfaqëson regjistrimin e depozitimit të parave cash të TCR
Id	Attribute	[1, 1]	Atributi i përdorur për krijimin dhe verifikimin e nënshkrimit elektronik. Vlera fikse "Kërkesë".
Version	Attribute	[1, 1]	Atributi i përdorur për të specifikuar përputhjen me skemën XSD. Për këtë version, vlera fikse është "2".
Header	Element	[1, 1]	Elementi XML që përfaqëson titullin e mesazhit
UUID	Attribute	[1, 1]	UUID i gjeneruar nga pajisja elektronike e faturimit për çdo mesazh të dhënash të dërguara në CIS së
SendDateTime	Attribute	[1, 1]	Data dhe ora e dërgimit të mesazhit nga TCR në CIS
IsSubseqDeliv	Attribute	[1, 1]	A është dërguar mesazhi i kërkesës më vonë?
CashDeposit	Element	[1, 1]	Element XML që përfaqëson një kërkesë të vetme të gjendjes fillestare së parave cash
ChangeDateTime	Attribute	[1, 1]	Data dhe ora kur ka ndryshuar gjendja fillestare e parave cash
Operation	Attribute	[1, 1]	Operacioni i gjendjes së parave cash të kryera në regjistër
CashAmt	Attribute	[1, 1]	Sasia e gjendjes së parave cash në TCR
TCRCode	Attribute	[1, 1]	Kodi i TCR për të cilën është regjistruar gjendja fillestare e parave cash
IssuerNUIS	Attribute	[1, 1]	NIPT/NUIS e tatimpaguesit
Signature	Element	[1, 1]	Elementi XML me nënshkrimin elektronik

Tabela 20

### 3.6.1.1 Header

Element që përfaqëson kokën e mesazhit të të dhënave të kërkesës.

### 3.6.1.2 Header UUID

Element i gjeneruar nga TCR e tatimpaguesit. Në mënyrë unike identifikon mesazhin e kërkesës të dërguar nga TCR e tatimpaguesit në CIS. UUID duhet të ndërtohet sipas RFC4122, versioni 4.

Lloji i të dhënave	string
Gjatësia	36 karaktere
Modeli	[0-9a-fA-F]{8}-[0-9a-fA-F]{4}-[1-5][0-9a-fA-F]{3}-[89abAB][0-9a-fA-F]{3}-[0-9a-fA-F]{12}
Shembull	58e0a7d7-eebc-41d8-9669-0800200c9a66 58E0A7D7-EEBC-41D8-9669-0800200C9A66

Tabela 21

### 3.6.1.3 Header SendDateTime

